

Opinion lidhur me kërkesën e Shoqatës së Obstetërve dhe Gjinekologëve të Kosovës në lidhje me raportimin e të dhënave personale të pacientëve në Komisionin për Fertilizimin Asistuar Mjekësor.

Më datë 21/01/2016, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme Agjencia) ka pranuar kërkesë nga Shoqata e Obstetërve dhe Gjinekologëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme SHOGJK) në lidhje me atë nëse raportimi me të dhëna personale të pacientëve në Komisionin për Fertilizimin Asistuar Mjekësor (në tekstin e mëtejme KFAM) bie ndesh me Ligjin 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

KFAM në kërkesën e tyre drejtuar institucioneve shëndetësore që kryejnë frytnimin e asistuar mjekësor ka kërkuar këto të dhëna:

- Të dhëna personale të pacientit, moshën, vitin e lindjes, profesionin, vendbanimin;
- Herën për të cilën i nënshtrohet IVF-it;
- Emrin e mjekut/mjekëve që kanë kryer IVF-in.

Raportimi me të dhëna personale pranë Komisionit për Fertilizimin Asistuar Mjekësor nuk është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sipas nenit 38 (paragrafi 1), të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP), Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme Agjencia") ka për detyrë që të këshillojë institucionet publike për të gjitha çështjet lidhur me mbrojtjen e të dhënave kur kjo kërkohet, duke përfshirë edhe interpretimin dhe zbatimin e ligjeve përkatëse.

Neni 2 paragrafi 1 nënparagrafi 1 i Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në tekstin e mëtejme LMDHP) përcakton që e dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik të identifikuar ose të identifikueshëm (subjekt i të dhënave); person i identifikueshëm është person i cili mund të identifikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në veçanti në bazë të një numri të identifikimit ose të një e më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij ose saj fizik, psikologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror.

Neni 2, paragrafi 1, nënparagrafi 16, përcakton se të dhëna personale të ndjeshme janë të dhënat që zbulojnë origjinën etnike ose racore, pikëpamjet politike ose filozofike, përkatësitë fetare, anëtarësimin në sindikatë ose çdo e dhënë për gjendjen shëndetësore

ose jetën seksuale, çfarëdo përfshirje në ose heqje nga evidencat penale ose të kundërvajtjeve që ruhen në pajtim me ligjin.

Të dhënave personale të ndjeshme, sipas nenit 6, paragrafit 1, nënparagrafit 4 dhe 6 të LMDHP-së mund të përpunohen për qëllime të veprimtarive legjitime nga institucionet dhe nëse ato përpunohen nga punonjësit shëndetësorë ose personeli shëndetësor në pajtim me ligjet përkatëse për qëllimet e mbrojtjes së shëndetit të shoqërisë, individëve dhe menaxhimit ose funksionimit të shërbimeve shëndetësore.

Në nenin 43, paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor, thuhet që institucioni shëndetësor obligohet që të mbajë regjistër të dhuruesve të qelizave ligjore, në paragrafin 2 nënparagrafi 1, 2, 3, 4 të po këtij neni thuhet që regjistri përmbanë: të dhënat personale, të dhënat për gjendjen shëndetësore të dhuruesve të qelizave gjinore dhe të dhënat anamnesticke për prindërit e dhuruesve, ditën muajin dhe vitin kur qelizat janë dhuruar, ruajtur ose shfrytëzuar, rezultatet nga kontrollat e dhuruesve dhe analizave të tyre gjinore, të dhënat për shtatzëninë dhe lindjen e fëmijës së ngjizur me FAM, me qeliza gjinore të dhuruara.

Në paragrafin 4 të po të njëjtit nen, thuhet që institucioni shëndetësor obligohet që çdo gjashtë (6) muaj t'i dërgojë raport me të dhënat nga regjistri i vet KFAM.

Duke pasur parasysh kërkesën tuaj nëse raportimi me të dhëna pranë KFAM përmbanë shkelje të dispozitave LMDHP-së, si rrjedhojë kërkesa e parashtruar nga KFAM nuk bie ndesh me LMDHP, pasi që institucionet shëndetësore që përpunojnë të dhëna të ndjeshme ose më saktësisht kryejnë frytnim të asistuar mjekësor janë të obliguar që të bëjnë raport me të dhëna nga regjistri i tyre në KFAM.

Andaj, në bazë të parimeve të përpunimit të të dhënave personale, konkretisht nenit 3, paragrafi 1 dhe nenit 5, paragrafi 1, nënparagrafi 3 të LMDHP-së, thuhet që të dhënat personale përpunohen në mënyrë të paanshme dhe të ligjshme pa e cenuar dinjitetin e të dhënave personale si dhe përpunim i ligjshëm i të dhënave personale është nëse përpunimi është i domosdoshëm për respektimin e obligimit ligjor të cilit i nënshtrohet kontrolluesi, si rrjedhojë e kësaj institucionet shëndetësore janë të obliguara që në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2013 për Frytnimin e Asistuar Mjekësor të bëjnë raportim pranë KFAM.

KFAM është i obliguar që të bëjë sigurimin e të dhënave personale në momentin e raportimit të institucioneve shëndetësore, në bazë të nenit 16, paragrafi 2, thuhet që kontrolluesit e të dhënave dhe përpunuesit e të dhënave duhet të përshkruajnë në aktet e tyre të brendshme procedurat dhe masat e vendosura për sigurinë e të dhënave

personale dhe duhet të emërojnë në formë të shkruar personat kompetentë që janë përgjegjës për sistemin e dosjeve dhe personat, të cilët, për shkak të natyrës së punës së tyre, duhet të përpunojnë të dhëna personale.

Duke i marrë parasysh argumentet dhe shqyrtimet e mësipërme, mund të konkludohet se raportimi me të dhëna personale pranë Komisionit për Fertilizimin Asistuar Mjekësor nuk është në kundërshtim me Ligjin Nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.